



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

# DREJT KRIJIMIT TË NJË PRAKTIKE POZITIVE PËR INFORMACIONIN LIDHUR ME PROCESIN E VETTINGUT TË GJYQTARËVE/PROKURORËVE



**“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale urdhëron Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për të ofruar informacionin e kërkuar nga KSHH”**

- Pas refuzimit të dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vendosi: “Urdhërimin e KPK-së, për vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës lidhur me kërkesën e KShH-ë për informacion duke respektuar kufizimet ligjore”.

## **DREJT KRIJIMIT TË NJË PRAKTIKE POZITIVE PËR INFORMACIONIN LIDHUR ME PROCESIN E VETTINGUT TË GJYQTARËVE/PROKURORËVE**

Në muajin Tetor 2022, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) kërkoi zyrtarisht nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK-së), organit përgjegjës për vettingun në shkallë të parë, vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit për numrin e gjyqtarëve që janë pushuar apo kanë dhënë dorëheqjen gjatë periudhës Janar 2021-Tetor 2022, si dhe nëse janë evidentuar shkelje të tjera që përbëjnë vepër penale që ndiqen kryesisht ose me iniciativë në kuadër të procesit të Vettingut.

Në muajin Nëntor 2022, autoriteti publik vuri në dispozicion një informacion të pjesshëm, në mungesë të kopjes së dokumentacionit të kërkuar, i cili do të bëhej objekt studimi nga KShH. Në këndvështrimin e KShH-së, e drejta e informimit në këtë rast ishte kufizuar në kundërshtim me nenin 17, pika 2/b e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Bazuar në analizën e sipërcituar, KShH iu drejtua zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila pasi shqyrtoi ankimin tonë administrativ, vendosi:

***“Urdhërimin e KPK-së, për vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës lidhur me kërkesën e ankuesit për informacion duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” brenda datës 28.02.2023”.***

**KShH vijon ndjekjen e çështjes për shkak se autoriteti publik ende nuk ka përcjellë informacionin e kërkuar.**